

## AKT THEMELIMI I SHOQËRISË TREGTARE

“G.E.A Green Energy” sh.p.k

Tiranë më datë 28 / 04 / 2022

### NENI 1

Shoqëria Tregtare “G.E.A Green Energy” sh.p.k (në vazhdim Shoqëria) formohet si shoqëri tregtare sipas ligjit 9901, datë 14.04.2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare” të ndryshuar dhe do të funksionojë në bazë të këtij akti themelimi dhe statuti të miratuara prej saj.

### NENI 2

#### Emri i Shoqërisë

Shoqëria, do të dalë në qarkullimin juridiko-civil me emrin “G.E.A Green Energy” sh.p.k

### NENI 3

#### Objekti i veprimtarisë

Shoqëria do të ketë si objekt ushtrimin e veprimtarisë në fushën e energjisë elektrike nga centrali fotovoltaik

Konkretisht:

1. Prodhimi, transmetimi, shpërndarja dhe shitja e energjisë elektrike nga centrali fotovoltaik
2. Ndërtimi, operimi dhe vënia në punë e parkut fotovoltaik.

### NENI 4

#### Selia e Shoqërisë

Selia e Shoqërisë ndodhet në adresën: **Rruga e Barrikadave; Qendra Turdiu; K2; N17, Tiranë, Shqipëri.**

### NENI 5

#### Kapitali i Shoqërisë

Kapitali themeltar i nënshkruar i shoqërisë do të jetë i përbërë nga kontributi i ortakëve themelues të kësaj Shoqërie, në para në vlerën **10.000.000 (dhjetë milion) lekë.**

Kapitali ndahet në 3 (tre) pjesë dhe pronësia e kuotave nga ortakët e shoqërisë vijon si më poshtë:

1. Shoqëria “ALIU ROAD HOUSE” sh.p.k, regjistruar pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit me NUIS K83211201N, në cilësinë e ortakut themelues zotëron 50 % të vlerës së kapitalit themeltar, të barabartë me 1(një) kuotë me vlerë 5.000.000 (pesë milion) Lekë.
2. Shoqëria “GAINSBURG” sh.p.k, regjistruar pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit me NUIS L09110504G, në cilësinë e ortakut themelues zotëron 25 % të vlerës së kapitalit themeltar, të barabartë me 1(një) kuotë me vlerë 2.500.000 (dy milion e pesëqindmije) Lekë.
3. Shoqëria “EDICOM” sh.p.k, regjistruar pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit me NUIS J61813038H, në cilësinë e ortakut themelues zotëron 25 % të vlerës së kapitalit themeltar, të barabartë me 1(një) kuotë me vlerë 2.500.000 (dy milion e pesëqindmije) Lekë.

Kapitali themeltar është nënshkruar nga ortakët themelues në total. Vlerësimi dhe pagesa e kapitalit themeltar është nënshkruar nga Ortakët Themelues.

## NENI 6

### Kohëzgjatja e shoqërisë

Shoqëria zhvillon aktivitetin e saj për një afat kohor të pacaktuar. Afati i aktivitetit fillon mbas regjistrimit të Shoqërisë në Regjistrin Tregtar.

## NENI 7

### Organet Drejtuese

Duke ju referuar ligjit nr. 9901, datë 14.04.2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”, i ndryshuar, organet drejtuese të shoqërisë janë si më poshtë vijon:

1. Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve – Organi më i lartë vendimmarrës;
2. Administrator – Organi ekzekutiv dhe administrativ i shoqërisë.

Mënyra e organizimit të tyre dhe funksionimit është e përcaktuar në Statutin e Shoqërisë.

Shoqëria do të administrohet nga Administratori, i cili zgjidhet për një afat pesë vjeçar me të drejtë rigjedhjeje.

Administratori i parë i shoqërisë është **z. Denis MARTOPULLO**, lindur më 21.07.1975 në Durrës, Shqipëri, shtetas Shqiptar, identifikuar nëpërmjet ID me nr. H50721139H personal, person madhor me zotësi të plotë juridike për të vepruar, me një afat emërimi prej 5 (pesë) vitesh, afat që fillon nga data e regjistrimit të shoqërisë pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit.

Shoqëria përfaqësohet para çdo organi administrativ, gjyqësor, enti publik apo privat dhe në marrëdhënie me të tretët nga administratori, i cili ushtron këto të drejta në përputhje me Statutin e shoqërisë dhe legjislacionin në fuqi.

## NENI 8

Ekspertët kontabël të autorizuar të Shoqërisë do të emërohen në përputhje me ligjin në fuqi dhe për çdo vit vit financiar vjetor për veprimtarinë e shoqërisë. Shoqëria do të emërojë ekspertin kontabël.

#### NENI 9

Ortakët themelues mund të vendosin me vullnetin e tyre, për pjesëmarrjen në Shoqëri të tjera dhe të krijojnë çdo lloj aktiviteti tjetër privat, me përjashtim të kufizimeve të përcaktuara me ligj.

#### NENI 10

Organizimi dhe funksionimi i shoqërisë, ngritja e degëve apo filialeve të saj, do të bëhet në përputhje me dispozitat e ligjit përatës dhe statutit.

#### NENI 11

Ortakët detyrohen të ruajnë sekretin e themelimit dhe veprimtarisë së Shoqërisë. Të punësuarit dhe të ngarkuarit me drejtimin e Shoqërisë mbajnë përgjegjësi dhe detyrohen të zhëmbtojnë Shoqërinë për dëmet që i janë shkaktuar për faj të tyre gjatë ushtrimit të veprimtarisë së tyre.

#### NENI 12

#### Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

Mosmarrëveshje që mund të lindin midis ortakëve apo midis ortakëve dhe Shoqërisë dhe të cilët mund të kenë si objekt të drejta si rrjedhim i raporteve me shoqërinë do të zgjidhen nga Gjykata e Rretit Gjyqësor Tiranë.

#### NENI 13

#### Dispozitat përfundimtare

Akt Themelimi hartohet në 3 (tre) kopje në gjuhën shqipe.

#### ORTAKËT

